

Emertimi dhe Forma Ligjore

"Ujesjelles" Berat-Kucove

Shoqeri anonime

NIPT-I

J62903166T

Adresa e Selise

LAGJA "13 SHTATORI" BERAT

Data e krijimit

17.07.2000

Nr. i Rregjistrimit Tregtar

24148

Veprimtaria kryesore

Prodhimi dhe furnizimi me uje te

pijshem dhe largimi i ujrave te

te ndotura.

PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2010

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2010 Deri 31.12.2010

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 24.03.2011

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA _____

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE O LEKE

Raport i Audituesve të Pavarur

Për Aksioneret e shoqërisë "UJSJELLESË BERAT-KUÇOVË" Sh.a Adresa selise: Lagjja "13 Shtatori", Berat

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "UJSJELLESË BERAT-KUÇOVË" Sh.a, të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2010, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur në atë date, si dhe një përmbledhje e metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendëshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimit; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatëshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat e dhëna.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u krye në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatëshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatëshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ekspert Kontabël të Regjistruar

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit që vijon.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare që audituam, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit(gjëndjes) financiare të shoqërisë "UJSJELLESË BERAT-KUÇOVË" Sh.a, në datën 31 Dhjetor 2010, të rezultatit financiar dhe flukseve të saj të parave për ushtrimin e mbyllur, dhe janë në pajtim me Standartet Shqipëtare të Rraportimit Financiar.

Dhimo DUNDO



Afrim SULI



Ekspert Kontabël i Regjistruar

Berat, më 30 Mars 2011

Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2010

	ZERI I BILANCIT	She nime	Viti ushtrimor 2010	Ushtrimi paraardhes
A	AKTIVET			
1	Aktivët Afatshkurtëra			
1	Mjete monetare	3	6,021,910	5,675,895
2	Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim		0	0
(i)	-Derivatet		0	0
(ii)	-Aktivët e mbajtura për tregtim		0	0
	Totali 2		0	0
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra	4	329,421,684	305,047,996
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	4	324,379,190	299,997,582
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	5,042,494	5,050,414
(iii)	Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	Totali 3		329,421,684	305,047,996
4	Inventari	6	13,675,927	14,068,372
(i)	Lëndët e para	6	13,675,927	14,068,372
(ii)	Prodhim në proces	6	0	0
(iii)	Produkte të gatshme		0	0
(iv)	Mallra për rishitje		0	0
(v)	Parapagesat për furnizime	6	0	0
	Totali 4		13,675,927	14,068,372
5	Aktivët biologjike afatshkurtra		0	0
6	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje		0	0
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	52,505,307	54,092,620
	Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		401,624,828	378,884,883
II	Aktivët afatgjata		0	0
1	Investimet financiare afatgjata		0	0
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		0	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		0	0
	Totali 1.		0	0
2	Aktive afatgjata materiale	8	815,098,913	836,137,038
(i)	Toka	8	80,626,464	80,626,464
(ii)	Ndërtesa	8	699,070,480	715,538,638
(iii)	Makineri dhe pajisje	8	33,695,759	37,877,145
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	8	1,706,210	2,094,790
	Totali 2		815,098,913	836,137,038
3	Aktivët Biologjike afatgjata		0	0
4	Aktivët afatgjata jomateriale		0	0
(i)	Emri i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		0	0
	Totali 4		0	0
5	Kapital aksionar i papaguar		0	0
6	Aktive të tjera afatgjata		329,065,966	25,651,118
	Totali i aktiveve Afatgjata (II)		1,144,164,879	861,788,156
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		1,545,789,707	1,240,673,039

"UJESJELLES" BERAT- KUÇOVE sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2010 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	Detyrimet Afatshkurtëra			
1	Derivativët		0	0
2	Huamarrjet	9	22,547,671	18,498,801
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		0	0
(ii)	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	9	22,547,671	18,498,801
(iii)	Bono të konvertueshme		0	0
	Totali 2		22,547,671	18,498,801
3	Huat dhe parapagimet	10	122,617,328	123,706,414
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	10	38,632,523	36,267,635
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	10	6,121,267	6,133,716
(iii)	Detyrime tatimore	10	76,778,710	78,405,296
(iv)	Hua të tjera	10	1,084,828	2,899,767
(v)	Parapagimet e arkëtuara	10	0	0
	Totali 3	10	122,617,328	123,706,414
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra		0	0
5	Provizionet afatshkurtra		0	0
	Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		145,164,999	142,205,215
II	Detyrime afatgjata		0	0
1	Huat afatgjata	11	555,819,527	260,295,196
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare	11	555,819,527	260,295,196
(ii)	Bonot e konvertueshme		0	0
	Totali 1		555,819,527	260,295,196
2	Huamarrje të tjera afatgjata		0	0
3	Provizionet afatgjata		0	0
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra	12	138,287,515	125,994,857
	Totali i detyrimeve afatgjata (II)		694,107,042	386,290,053
	Totali i detyrimeve (I+II)		839,272,041	528,495,268
III	Kapitali		706,517,666	712,177,771
1	Aksionet e pakicës		0	0
	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë			
2	mëmë		0	0
3	Kapitali aksionar	13	663,914,000	663,914,000
4	Primi i aksionit		15,775,830	15,775,830
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)		0	0
6	Rezerva statusore		0	0
7	Rezerva ligjore		0	0
8	Rezerva të tjera		75,066,303	75,066,303
9	Fitimet e pashpërndara	14.7	(42,578,362)	534,907
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	14.7	(5,660,104)	(43,113,269)
	Totali i kapitalit (III)		706,517,666	712,177,771
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		1,545,789,707	1,240,673,039

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-17

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2010 deri më 31 Dhjetor 2010

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres

		Shëni me	Viti ushtrimor 2010	Ushtrimi paraardhes
1	Shitjet neto	14.1	140,911,800	138,512,947
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	14.2	68,209,637	48,887,987
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		0	(4,950)
4	Materialet e konsumuara	14.3	(49,823,484)	(39,977,291)
5	Kosto e punes	14.4	(98,451,172)	(96,138,436)
	<i>Pagat</i>		(85,109,333)	(81,835,937)
	<i>Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore</i>		(13,341,839)	(14,302,499)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	8	(35,235,668)	(36,818,159)
7	Shpenzime te tjera	14.5	(23,176,905)	(27,531,407)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)		(206,687,229)	(200,465,293)
9	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/3-8)		2,434,208	(13,069,309)
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		0	0
12,1	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata</i>		0	0
12,2	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	14.6	(3,893,078)	(4,199,342)
12,3	<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>	14.6	(4,201,235)	(25,844,618)
12,4	<i>Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare</i>	14.6	0	0
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)		(8,094,313)	(30,043,960)
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)		(5,660,105)	(43,113,269)
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	13.5	0	0
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)		(5,660,105)	(43,113,269)
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara			

"UJESJELLES" BERAT- KUCOVE sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2010 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2010 deri më 31 Dhjetor 2010

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2010	Ushtrimi paraardhes
Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi para tatimit	14.7	(5,660,105)	(43,113,269)
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	8	35,235,668	36,818,159
Humbje nga kembimet valutore			
Të ardhura nga investimet		293,851	2,398,275
Shpenzime per interesa		3,940,259	4,236,160
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera	3,4	(24,373,688)	(25,526,170)
Rritje/renie në tepricën e inventarit	6	392,445	2,717,989
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti	9	2,959,785	32,152,594
Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet		12,788,215	9,683,738
Interesi i paguar	14	(3,940,259)	(4,236,160)
Tatimfitimi i paguar			
	7	1,587,313	1,587,313
<i>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		10,435,269	7,034,891
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar ____ minus parate e arketuara			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(317,906,243)	(35,565,715)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	14.5	0	0
Interesi i arketuar			
Dividendet e arketuar			
<i>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet investuese</i>		(317,906,243)	(35,565,715)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner			
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	11	295,524,331	48,173,692
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		0	0
Dividendet e paguar			
Grante afatgjata		12,292,658	(17,366,786)
<i>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet financiare</i>		307,816,989	30,806,906
Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		346,015	2,276,082
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		5,675,895	3,399,813
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		6,021,910	5,675,895

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-17

Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2010 deri më 31 Dhjetor 2010 në një pasqyrë të pakonsoliduar

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Pozicioni më 31 Dhjetor 2008	663,914,000	15,775,830	-	75,066,303	534,907	755,291,040
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	663,914,000	15,775,830	-	75,066,303	534,907	755,291,040
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(43,113,269)	(43,113,269)
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2009	663,914,000	15,775,830	-	75,066,303	(42,578,362)	712,177,771
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(5,660,104)	(5,660,104)
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2010	663,914,000	15,775,830	-	75,066,303	(48,238,467)	706,517,666

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese faqe 6-17

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2010

1. Informacione te pergjitheshme

"Ujesjelles" Berat-Kuçove sh.a eshte nje shoqeri e krijuar nga bashkimi me perthithje i "Ujesjelles" sh.a Kuçove nga "Ujesjelles" sh.a Berat bashkim i realizuar me vendim te asamblese se shoqerive ne muajin Maj 2008. Kapitali i regjistruar i shoqerise aktualisht eshte 663.914.000 leke i ndare ne 663.914 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion dhe zoterohet 56.989% nga Bashkia Berat, 15.214% nga Bashkia Kuçove, 11.91% nga Komuna Otlak, 4.062% nga Komuna Perondi, 5.342% nga Komuna Kozare dhe 6.483% nga Komuna Vertop. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise eshte prodhimi dhe furnizimi me uje te pijshem i popullates dhe largimi i ujrave te ndotura .

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivite të tjera të cilat nuk janë aktivite investuese ose financuese. Veprimtari investuese janë blerja, nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare. Aktivite financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

Aktivet financiare

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kerkesa te arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kerkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështrësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2010 janë 1 euro=138.77 leke dhe 1 dollar=104 leke.

Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbar të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për ti sjelle inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën lineare, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen.

Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.

Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha reziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin perfaqson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2010 është 10 % aq sa ka qene në ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimin e shtyrë.

3. Aktive monetare (likujditete në banke dhe arke)

Gjendjet e mjeteve monetare, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 janë si më poshte:

"UJESJELLES" BERAT- KUCOVE sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2010 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2010		Gjendja ne 31.12.2009	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	5,972,416		5,675,422	
Arka	leke	49,494		473	
Shuma Mjete monetare		6,021,910	x	5,675,895	x

Gjendjet e llogarive te mjeteve monetare te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare te bankave perkatese dhe inventaret fizike.

4. Aktive te tjera financiare afatshkurtera- Llogari/Kerkesa te arketueshme

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Kliente per mallra, produkte e sherbime	338,131,507	313,749,899
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb	13,752,317	13,752,317
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
Shuma Kerkesa te arketueshme	324,379,190	299,997,582

"Kliente per mallra produkte e sherbime" pasqyrojne vleren e faturave te pa likujduara ne fund te ushtrimit. Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve pasqyron klientet te cilet jane vleresuar me mundesi te pakta arketimi.

5. Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Shteti per tatime dhe taksa	4,084,099	4,084,099
Shteti -Tatime te tjera (teprica debitore)	4,084,099	4,084,099
Personeli (teprica debitore)	958,395	966,315
Shuma	5,042,494	5,050,414

Drejtimi ka gjykuar se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

6. Inventari

Inventari eshte i perbere si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Lende te para		
Materiale te para dhe materiale te tjera	13,675,927	14,068,372
Shuma Lende te Para	13,675,927	14,068,372
Shuma inventar	13,675,927	14,068,372

"UJESJELLES" BERAT- KUÇOVE sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2010 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër perputhen me të dhenat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2010. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogarite e rezultatit me mënyrën e inventarit të përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda hyrje e parë dslje eparë ("FIFO").

Drejtimi ka gjykuar se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të tij.

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra janë të perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Shpenzime të periudhave të ardhshme	52,505,307	54,092,620
Shpenzime të llogaritura		
Shuma parapagime dhe shpenzime të shtyra	52,505,307	54,092,620

Shpenzime të periudhave të ardhshme (për tu shpërndarë në disa ushtrime) përfaqësojnë shpenzimet për shërbimet konsultuese për projektin e furnizimit me ujë Berat-Kuçovë shërbime eksperte për zbatimin e programeve të reduktimit të humbjeve të ujit. Shoqëria ka përcaktuar një plan amortizimi të këtyre shpenzimeve në shumën 1.587.313 lekë në vite deri në vitin 2042 kur përfundon shlyerja e huasë afatgjatë (shih shënimin nr.10)

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-te) përbehen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri pajisje, etj.	Mjete transporti	Pajisje zyre e informatike	Inventar i imet afatgjatë	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2010	80,626,464	1,135,960,047	55,577,309	24,622,696	5,302,022	1,807,084	1,303,895,622
Shtesat 2010	0	14,212,356	0		80,700	198,339	14,491,395
Pakesimet 2010	0	4,913,154	4,300	800,000	15,559	107,963	5,840,976
Kosto e AAM me 31.12.2010	80,626,464	1,145,259,249	55,573,009	23,822,696	5,367,163	1,897,460	1,312,546,041
Amortizimi AAM 01.01.2010	0	420,421,409	24,505,164	17,817,696	3,894,291	1,120,025	467,758,584
Amortizimi ushtrimor	0	30,386,664	2,882,483	1,298,903	469,007	99,170	35,136,227
Amortizimi për daljet AAM	0	4,619,303	4,300	800,000	15,559	8,521	5,447,683
Amortizimi i AAM me 31.12.2010	0	446,188,770	27,383,347	18,316,599	4,347,739	1,210,674	497,447,127
							0
Vlera neto e AAM 31.12.2009	80,626,464	715,538,638	31,072,145	6,805,000	1,407,731	687,059	836,137,037
							0
Vlera neto e AAM 31.12.2010	80,626,464	699,070,479	28,189,662	5,506,097	1,019,424	686,786	815,098,913

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2010. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbyljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane lineare (shih shenimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

9. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huamarrjet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Kthimet/ripagesat e huave afatgjata		
Kesti i llogaritur		
Interesi i llogaritur	22,547,671	18,498,801
Shuma Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	22,547,671	18,498,801
Shuma huamarrjet	22,547,671	18,498,801

"Kthimet/ripagesat e huave afatgjata" perfaqeson interesat dhe komisionin e angazhimit te papaguar te huase afatgjate qe do paguhet brenda 12 muajve te ardhshem. Shih shenimin nr.11 ne te cilin jane trajtuar kredite e marra.

Detyrimet afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Te pagueshme ndaj furnitoreve		
Furnitore per mallra, produkte e sherbime	38,632,523	36,267,635
Te pagueshme ndaj punonjesve		
Detyrime ndaj personelit per paga dhe shperblime	6,121,267	6,133,716
Paradhenie per punonjesit		
Shuma Te pagueshme ndaj punonjesve	6,121,267	6,133,716
Detyrime tatimore		
Detyrime per sigurime shoqerore shendetsore	7,105,675	8,455,014
Shteti per tatime e taksa		
Akciza	0	0
Tatim mbi te ardhurat personale	4,743,831	4,104,443
Tatim mbi fitimin	168,952	368,953
Tvsh per tu paguar	53,021,044	53,993,078
Taksa lokale	1,019,875	764,475
Te tjera tatime per tu paguar	10,696,493	10,696,493
Tatim ne burim	22,840	22,840
Shuma Shteti per tatime e taksa	69,673,035	69,950,282
Shuma Detyrime Tatimore	76,778,710	78,405,296
Huate tjera		
Debitore te tjere kreditore te tjere	1,084,828	2,899,767
Dividende per tu paguar	0	0
Shuma huate tjera	1,084,828	2,899,767
Parapagimet e arketuara	0	0
Shuma Huate dhe Parapagimet	122,617,328	123,706,414

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarive sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi gjykon se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" përbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit në 31.12.2010. "Detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore" përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2010. "Shteti për tatim taksa" pasqyrojnë detyrimin për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi të ardhurat personale tatime të tjera të prapambetura, detyrimet e kontabilizuara dhe të papaguara të akt-vlerësimeve tatimore dhe tatim fitimin e rezultuar nga rakordimet përfundimtare, në 31 Dhjetor 2010.

Në "Hua të tjera" janë paraqitur detyrimet për marrëdhënie financiare të perkoshme.

10. Detyrime Afatgjata-Huate Afatgjata

Huate afatgjata përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare		
Bankat	555,819,527	260,295,196
Obligacionet		
Qeraja financiare		
Shuma Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare	555,819,527	260,295,196
Shuma Hua afatgjata	555,819,527	260,295,196

Me 15.01.2003 midis Kreditantalt für Wiederaufbau, Frankfurt am Main (KfW), Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave Tiranë dhe Agjensisë së Ekzekutimit të Projektit, Shoqëria Ujesjelles Berat-Kuçove është lidhur marrëveshja e kredise së projektit "Furnizimi me Ujë Shqipëria e Mesme" Komponenti Berat Kuçove. Shuma e huase është 6.646.794.46 EUR. Kjo hua po përdoret për të financuar nxjerrjen, transmetimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm për zonën e Beratit dhe të Kuçovës. Nënhuamarrësi shoqëria "Ujesjelles" sh.a Berat-Kuçove do të paguajë Ministrisë së Financave një interes prej 0.75 % në vit mbi tërë fondet e tërhequra dhe një tarifë (komision) angazhimi 0.25% në vit për pjesën e pa disbursuar me dy keste me 30 Qershor dhe 30 Dhjetor të çdo viti. Ky interes llogaritet mbi tepërcën ditore të kredise. Shlyerja e huase do të bëhet me dy keste fikse 110.000 Eur për çdo keste, me 30 Qershor dhe 30 Dhjetor, duke filluar në datën 30 Dhjetor 2012 deri në datën 30 Qershor të vitit 2042. Ministria e Financave nga ana e saj do t'ia paguajë këto keste KfW-së. Në rast mospagese të detyrimeve në afatet e përcaktuara do të aplikohen interesvonesa. Deri më 31.12.2010 janë përdorur nga projekti 4.005.329.15 Eur ose 555.819.527 leke. Interesat e llogaritura për huane e disbursuar janë 58.280.68 Eur dhe komisioni i angazhimit për huane e pa disbursuar është 110.749.93 Eur. Deri më 31.12.2010 janë shlyer 6.547.69 Eur inters. Shuma e interesit dhe e komisionit të angazhimit e pashlyer më 31.12.2010 është 162.482.32 Eur ose 22.547.671 leke. Këto interesa dhe komisione angazhimi janë klasifikuar si detyrime afatshkurtera.

11. Grantet dhe te Ardhurat e Shtyra(Afatgjata)

Grantet dhe te ardhurat e shtyra (afatgjata) perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Grante afatgjata	138,287,515	125,994,857
Interesa pasive te llogaritura		
Te ardhura te periudhave te ardheshme		
Shuma Grantet dhe te ardhurat e shtyra afatgjata	138,287,515	125,994,857

Grantet afatgjata perfaqesojne vleren e mbetur te Aktiveve Afatgjata Materiale te mara falas.

12. Kapitalet e veta

Kapitali themeltar perbehet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Kaitali i paguar	663,914,000	663,914,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar		
Shuma Kapitali themeltar	663,914,000	663,914,000

Kapitali i regjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me date 31.12.2010 ai eshte 663.914.000 leke.

13. Fitimi(humbja) e vitit financiar

14.1 Shitjet neto

Shitjet neto perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Shitje e produkteve te gateshme	123,989,014	122,562,245
Shitja e punimeve dhe e sherbimeve	16,922,786	15,950,702
Shuma Shitje neto	140,911,800	138,512,947

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme te zhveshura nga TVSH-ja.

14.2 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:

"UJESJELLES" BERAT- KUCOVE sha

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2010 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Te ardhura nga shitjet e tjera		
Gjoha, kamatvonesa	1,071,036	900,251
Tarif uji	1,442,100	2,000,500
Shitje materiale	304,140	13,666
Te tjera (pakesimi i kreditoreve)	728,565	846,921
Shuma Te ardhura nga shitjet e tjera	3,545,841	3,761,338
Puna e kryer dhe e kapitalizuar	730,096	2,656,490
Te ardhura nga grantet	50,952,640	15,271,000
Te ardhura te tjera (Kuota pjese e granteve per investime)	12,981,060	27,199,159
Shuma Te ardhurat e tjera (nga veprimtarite e shfrytezimit)	68,209,637	48,887,987

14.3 Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet

Shpenzimet per mallrat, lendet e para dhe sherbimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Blerje/Shpenzime te materialeve	14,239,298	15,038,280
Blerje/Shpenzime te materialeve te tjera	0	0
Blerje/Shpenzime mallrash e sherbimesh	0	0
Blerje/Shpenzime te materialeve te tjera	35,584,186	24,939,011
Shuma Mallrat lendet e para dhe sherbimet	49,823,484	39,977,291

Konsumi i materialeve, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme dhe i perkasin ushtrimit 2010.

14.4 Shpenzime te personelit

Shpenzime te personelit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Pagat dhe shperblimet e personelit	85,109,333	81,835,937
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	13,341,839	14,302,499
Shuma Shpenzime te personelit	98,451,172	96,138,436

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

14.5 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Sherbime nga te trete		
Trajtime te pergjithshme	937,810	1,049,227
Qira	0	0
Mirembajtje riparime	417,735	514,770
Sigurime	331,060	366,034
Honorare	420,000	360,000
Shuma sherbim nga te trete	2,106,605	2,290,031
Sherbime te tjera		
Paga per keshillin mbikqyres	1,953,000	1,937,400
Te tjera	0	20,600
Personel jashte njesise	0	44,800
Publicitet reklame		
Shpenzime per ERU	608,265	2,359,928
Udhetime e Dieta	616,873	359,890
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	433,621	513,082
Shpenzime transporti	0	0
Shpenzime per sherbimet bankare	92,158	35,954
Shpenzime rroba pune per punonjesit	387,300	375,000
Shpenzime ushqimi punonjeseve	11,768,175	11,758,508
Materiale kancelari etj	0	281,570
Subvecione te dhena	310,940	0
Shpenzime te tjera per personelin	92,121	302,414
Shuma Sherbime te tjera	16,262,453	17,989,146
Kuota e shpenzimeve per tu shpendare	1,587,313	1,587,313
Tatime dhe taksa		
Taksa dhe tarifa vendore	247,800	221,100
Tatime te tjera	1,739,632	1,330,325
Shuma Tatime dhe taksa	1,987,432	1,551,425
Gjoha demshperblime	939,251	1,715,217
Humbje nga rivleresimi/Shitja e aktiveve	293,851	2,398,275
Te ardhura nga shitja e aktiveve	0	0
Vlera kontabel Neto e mbetur e AAM	293,851	2,398,275
Shuma shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	23,176,905	27,531,407

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumen e paguar ose te pagueshme.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

"Gjoha e demshperblime" perfaqesojne detyrimet dhe saksionet tatimore te rezultuara nga njoftim vleresimet e vitit 2010. Ato jane rimarre ne llogaritjen e fitimit tatimor, shenimi nr.14.7.

14.6 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë paraqitur si diferencë e te ardhurave me shpenzimet financiare:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat		
Te ardhurat nga interesat	47,181	36,818
Shpenzime për interesa	3,940,259	4,236,160
Shuma te ardhura dhe shpenzime nga interesat	(3,893,078)	(4,199,342)
Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit		
Fitim nga kembimet valutore	0	0
Humbje nga kembimet valutore	4,201,235	25,844,618
Shuma Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit	(4,201,235)	(25,844,618)
Shuma e ardhurat dhe shpenzimet financiare	(8,094,313)	(30,043,960)

14.7 Shpenzimet e Tatimit

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2010 dhe 2009 janë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2010	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2009
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	(5,660,105)	(43,113,269)
II SHPENZIME TE PA ZBRITESHME (+)		
1. Amortizimi tej normave fiskale		
2. Shpenzime për pritje e dhurime tej kufirit tatimor	939,251	1,715,217
3. Gjoha, penalitete, demshperblime		
4. Provizione që nuk njihen		
5. Shpenzime pa dokumenta të rregullta	310,940	0
6. Te tjera	1,250,191	1,715,217
III PJESA E HUMBYES SE MBARTUR (-)		
IV FITIM (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)	(4,409,914)	(41,398,052)
V SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN		
VI FITIMI(HUMBJA) NETO E USHTRIMIT	(5,660,105)	(43,113,269)

14. Transaksione të paleve të lidhura

Ne marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundshme, jo thjesht formën ligjore të tyre, në 31 dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

15. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe performancës financiare të shoqërisë, rezultojnë se në ushtrimin 2010 shoqëria ka stabilitet dhe zhvillim normal të biznesit. Drejtimi mendon se nuk ka rreziqe të ndërprerjes së veprimtarisë së saj për vitin në vazhdim.

16. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese të deklaruara në pasqyrat financiare 2009 janë të njëjta me ato të prezantuara në vitin aktual 2010.

HARTUESI

AFERDITA KOROVESHI



PER "UJESJELLES" BERAT- KUCOVE SHA

DREJTORI

FATMIR SHEHU

